



trainkos

HEKURUDHAT E KOSOVËS - TRAINKOS SH.A
KOMISIONI I AUDITIMIT

Nr. I/111

Datë: 26.07.2024

Në bazë të Nenit 21 të Ligjit Nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike, duke pasur parasysh Ligjin Nr. 04/L-111 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 03/L-087 për NP, Nenit 20.6 të Kodit të Etikës dhe Qeverisjes Korporative për NP, Komisioni i Auditimit i HK-Trainkos Sh.A, në Mbledhjen Nr. 10, të mbajtur më 26.07.2024, njëzëri mori këtë:

VENDIM

- I. Shfuqizohet Vendimi i Komisionit të Auditimit, Nr. I/05, për emërimin e z. **Armond Pirku** në pozitën e Zyrtarit për Auditim të Brendshëm të HK-Trainkos Sh.A.
- II. Detyrat dhe përgjegjësitë e Zyrtarit për Auditim të Brendshëm, në cilësinë e Ushtruesit të Detyrës do të vazhdojë t'i kryejë z. **Armend Shehu**, nga pozita e auditorit të brendshëm në HK-Trainkos Sh.A.
- III. Z. Shehu, detyrat dhe përgjegjësitë e tij do t'i kryejë në përputhje me legjislacionin e aplikueshëm për NP-të në Kosovë, Kodin e Etikës, Statutin dhe rregulloret tjera të aplikueshme në Ndërmarrje deri në zhvillimin e procedurave të rekrutimit dhe për zgjedhjes së ZAB apo deri në një vendim tjetër të Komisionit.
- IV. Vendimi hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit.

Arsyetim:

Marrë për bazë se pas përfundimit të procedurave të rekrutimit, sipas Konkursit të përsëritur të datës 08.05.2024, përkatësisht pas për zgjedhjes dhe të emërimit të z. Pirku në pozitën e ZAB, i njëjti ka njoftuar se nuk është i gatshëm që të pranojë angazhimin në këtë pozitë me arsyetimin se nuk i përgjigjet niveli i pagës së përcaktuar, Komisioni ka vendosur si në pikën I të këtij vendimi, ndërsa më qëllim që pozita e ZAB të mos mbetet vakante, Komisioni ka vendosur si në pikën II të këtij vendimi.

Këshilla Juridike: Ankesa kundër këtij vendimi mund të drejtohet në Gjykatën kompetente në afat prej tridhjetë (30) ditësh, nga data e pranimit të këtij vendimi.

Për Komisionin e Auditimit

Për:

Ruzhdi ZEQIRI - Kryesues

Iu dërgohet:

- Z. Armond Pirku
- Z. Armend Shehu
- Kryeshefit Ekzekutiv
- Aksionarit – NJPMNP
- Departamentit të Administratës
- Arkivit

